



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/R4-10, Prot.

Tiranë 18/12/2025

Nr.Dok. 202503135/10

Lënda : Rekomandim për marrjen e menjëhershme të masave për nxjerrjen e Udhëzimit në zbatim të Vendimit nr.722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre", Kreu IV, pika 5.

Drejtuar:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
TIRANË

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja R.J, në përmbajtjen e së cilës ankohet lidhur me mosdhënien e së drejtës për të përfituar paketën higjieno-sanitare për djalin e saj të sëmurë, D.J.

Në parashtrimet e saj, ajo shprehet se, shoqëron kudo djalin e saj 6 - vjeçar, pasi ai e ka të pamundur të komunikojë dhe për një kujdes shëndetësor të përditshëm përdor

mjete higjienike (pampers), sepse ai nuk është i aftë për të treguar nevojat e tij personale. Nga anëtarët e Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar Korçë (KSHVAK), është informuar se nuk është përfituese e paketës higjieno-sanitare, kategoria e personave që janë në gjendje të lëvizin.

Duke qenë se mosdhënien e së drejtës për të përfituar paketën higjieno-sanitare për djalin e saj, e konsideron shkelje të të drejtave ligjore të saj të ligjshme, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen institucionale të Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj si dhe në kuadër të promovimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Për qëllime të hetimit administrativ sa i përket kësaj ankese, fillimisht iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, e cila na informoi si më poshtë:

“D.J, është komisionuar pranë Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Korçë më datë 14.05.2025, dhe rezulton përfitues i pagesës të aftësisë së kufizuar Nivel 3, me kujdestar të herëpahershëm dhe periudhë përfitimi 01.06.2025-01.06.2028, me diagnozë dhe sindromat epileptike të gjeneralizuara.

Përsa i takon përfitimit të paketës higjieno-sanitare, në bazë të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019 “*Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre*”, si dhe *Udhëzuesit mbi vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar*, për nivelin me të cilin trajtohet D.J, nuk përfshihet përfitimi i paketës higjieno-sanitare”.

Nga dokumentacioni që disponojmë, konstatojmë se sipas Vërtetimit për Aftësinë e Kufizuar, me Vendimin nr. AK-205-015426 të KSHVAK, Korçë, rezulton se fëmija D.J është diagnostikuar ***me epilepsi e sindromë epileptike të gjeneruar si dhe me prapambetje mendore të rëndë***. Është pikëzuar nga anëtarët e këtij komisioni:

- Në nivelin e dëmtimit të aftësive funksionale, në nivelin “i rëndë”;
- Në përcaktimi e përfitimeve, niveli 3 (i rëndë);
- Në ndihmës personal, niveli 3 (mbështetje e herë pas hershme).

Duke marrë shkas nga ky rast individual, me dëmtime të rënda të aftësive funksionale, që nuk e ka përfituar paketën higjieno-sanitare, me qëllimin për t'u informuar se si është proceduar edhe me persona të tjerë në kushte të njëjta të gjendjes shëndetësore, Nivel 3 (i rëndë), kemi vijuar hetimin administrative të thelluar, duke adresuar me një kërkesë për shpjegime për Shërbimin Social Shtetëror, duke kërkuar informacion në lidhje me sa më poshtë vijon:

1. Arsyet e mosdhënies së paketës higjieno-sanitare, në kushtet e gjendjes së tij shëndetësore dhe e përcaktuar me nivel 3, i rëndë.
2. Sa vendime për përfitimin e paketës higjieno-sanitare janë dhënë për përfituesit e aftësisë së kufizuar nga Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar si dhe të Komisionit Epror të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, bazuar në pikën 5 të Kreut IV të VKM-së Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre", ku thuhet shprehimisht **përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.**

Në përgjigje të kërkesave tona, Shërbimi Social Shtetëror përcolli informacionin përkatës, që po përmbledhim më poshtë:

- Bazuar në dokumentacion në dosje dhe në intervistën e kryer nga KSHVAK, fëmija D.J, është vlerësuar përfitues i niveli të rëndë me ndihmës personal të herëpashershëm.
- Aktualisht vlerësimi për përfitimin e paketës higjieno sanitare bëhet në bazë të VKM nr. 78, datë 07.02.2007 "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë i ndryshuar, ku në pikën 1 përcaktohen kushtet për përfitimin e paketës higjieno sanitare."
- Invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike, të cilët e kanë përfituar këtë status me Vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) dhe që vlerësohen se kanë humbje të plotë të sensibilitetit dhe të motorikës nga niveli i dëmtimit, poshtë, në të dyja anësitë, përfitojnë një pagesë shtesë, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale te veçanta higjieno-sanitare".

- Nuk është dhënë asnjë vendim për përfitimin e paketës higjieno-sanitare nga Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në analizë të përgjigjes së përcjellë, konstatohet se, VKM-ja nr. 78, datë 07.02.2007, së cilës i referohet Shërbimi Social Shtetëror, ka si subjekt vetëm personat, të cilët janë përfitues të Statusit të Invalidit Paraplegjik-Tetraplegjik dhe jo personat, të cilët janë përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. Ndërkohë, që kërkesa jonë i referohet specifikisht kategorisë së personave, të cilët janë deklaruar si përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, vlerësuar nga Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në vijim të shqyrtimit të kësaj problematike, e cila prek një kategori personash me aftësi të kufizuar, të cilët mund ta kenë të nevojshëm përfitimin e paketës higjieno-sanitare, pasi plotësojnë kriteret e VKM-së nr. 722 datë 11.11.2019, iu ridrejtua Shërbimit Social Shtetëror:

1. A është nxjerrë akti nënligjor për vlerën e pagesës shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, të cilët janë vlerësuar nga Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar?
2. Nëse po, sa është vlera e kësaj pagese aktualisht?

Në përgjigjen e tij institucionale, Shërbimi Social Shtetëror na informon sa më poshtë:

Nuk ka asnjë akt nënligjor për vlerën e pagesës shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, të vlerësuar nga Komisioni Shumë Disiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar

Në analizë të përgjigjes së përcjellë nga Shërbimi Social Shtetëror, gjithashtu dhe pas një hulumtimi të thelluar të kuadrit normativ, që reflekton çështjen objekt shqyrtimi nga ana jonë, rezulton se, përgjatë periudhës 2019-2025, pra që nga data e miratimit të VKM-së Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre”, pavarësisht parashikimit të bërë në pikën 5, Kreu IV i këtij Vendimi, nga ana e KSHVAK-së vendore ashtu dhe nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë Shërbimit Social Shtetëror, nuk është dhënë asnjë vendim për përfitimin e kësaj pakete për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, të cilët janë deklaruar me Nivel “të rëndë”.

Në këtë kontekst, mungesa të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, së pari, është një shkelje flagrante e detyrimit ligjor për nxjerrjen e tyre, e paraparë shprehimisht në pikën 5,¹ Kreu IV, i VKM-së nr.722/2019, me një impakt të drejtpërdrejtë negativ në kategorinë e përfituesve, të cilët do të duhet të gëzojnë këtë të drejtë, nëse aktet nënligjore do të ishin miratuar. Së dyti, bie ndesh me parimin e mbështetjes shoqërore për kategoritë në nevojë dhe me detyrimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar, që burojnë nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”, ratifikuar nga shteti shqiptar, me Ligjin nr. 108/2012.

Sipas Konventës shtetet palë duhet të marrin parasysh mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha politikat dhe programet.

Kushtetuta e Shqipërisë, si një ndër objektivat sociale të shtetit shqiptar, ka përcaktuar, përkujdesjen dhe ndihmën për personat me aftësi të kufizuar.

Ky objektiv social, duhet të kthehet në një të drejtë të prekshme, nëpërmjet zbatimit efektiv të kësaj të drejte.

Kështu, nxitja dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes, është garantuar në Ligjin Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar.

Ligji Nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka për qëllim të përcaktojë përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore si dhe të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Kompensimi financiar duhet të jepet për të mbuluar koston e produkteve jetike, ditore, për personat me aftësi të kufizuar, materiale të domosdoshme të veçanta

¹ Përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjienosanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

higjiëno-sanitare, në të cilat përfshihen: mjete higjienike (pampers), dyshekë mbrojtës, kremëra mbrojtës për lëkurën, me qëllim parandalimin e krijimit të plagëve, letra të lagura etj.

Në zbatim këtij ligji, për një mbështetje financiare për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, VKM-ja Nr.722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre”, në pikën 5 të Kreut IV, ka parashikuar përfitimin e paketës higjiëno-sanitare për këtë kategori:

Përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjiëno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjiëno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Ky parashikimi i bërë në këtë akt nënligjor, duhet zbatuar nga Komisionet Mjekësore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në nivel vendor dhe qendror.

Sipas pikës 4, Kreu VI, të këtij vendimi, ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore e sociale dhe organet e njërive të vetëqeverisjes vendore, në të cilat zbatohet kjo skemë vlerësimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Por, në praktikë, ka rezultuar se deri më tani, nuk është dhënë asnjë vendim nga Komisionet e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar si në nivel vendor ashtu dhe qendror për përfitim të shpenzimeve të paketës higjiëno sanitare, pasi nuk ka një akt normativ që të ketë përcaktuar vlerën përkatëse të përfitimit, ndonëse personat që janë vlerësuar për gjendjet e tyre shëndetësore mund të kenë qënë në kushtet përfituese.

Siç është lehtësisht e kuptueshme, VKM -ja e sipërcituar, ua njeh të drejtën e përfitimit të paketës higjiëno-sanitare personave që gëzojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, por konstatojmë se nuk është buxhetuar vlëra e kësaj pakete. Si rrejedhojë, ky parashikim ligjor ka mbetur i pazbatuar, në kushtet e mungesës së buxhetimit të dedikuar për këtë çështje.

Mosnxjerrja e këtyre akteve, ka sjellë si pasojë moszbatimin e kësaj dispozite, duke penalizuar një kategori personash me aftësi të kufizuar, të cilët përpos përcaktimit të nivelit të gjendjes shëndetësore, të rënduar, do të duhet të ishin ligjërisht përfitues edhe të paketës higjiëno-sanitare.

Gjithashtu, shtojmë faksin se, duke qënë ky akt nënligjor, vlerën për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjiëno-sanitare, e referon në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, rezulton se në legjislacionin për mbrojtjen sociale, ka vetëm një përcaktim ligjor për masën e këtij rimbursimi. Konkretisht në VKM-në nr. 78,

datë 07.02.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar.

Avokati i Popullit gjykon se kjo është një shkelje tejet flagrante e detyrimit të administratës shtetërore, për zbatimin e plotë dhe efektiv të legjislacionit në fuqi në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara.

Dhënia e së drejtës për të përfituar paketën higjieno-sanitare do të ndikonte sadopak në uljen e varfërisë për këta persona, të cilët nuk gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, por që e kanë të domosdoshme përfitimin e kësaj të drejte.

Evidentojmë faktin, se problematika e prezantuar më lart, bie ndesh pikërisht me parimin e sigurisë juridike.

Parimi i sigurisë juridike, është një element esencial i parimit të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë e referon konceptin e sigurisë juridike, tek e drejta e fituar, pritshmëria e ligjshme dhe besimi i qytetarëve tek shteti për pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara.

Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për këtë arsye, çmojmë se:

Duhet të fillojë në mënyrë të menjëhershme procedura e për nxjerrjen e Udhëzimit në zbatim të Vendimit nr.722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre”, Kreu IV, pika 5, me qëllim që subjektet e së drejtës të gëzojnë efektivisht të drejtat e përcaktuara në këtë akt nënligjor.

Sipas nenit 4 të Ligjit nr.9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Ministritë janë përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në fushën e tyre të veprimtarisë.

Ndaj, për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore nga ana e administratës shtetërore, për realizimin e të drejtave të garantuara për personat me aftësi të kufizuara, për forcimin e sistemit të mbrojtjes sociale, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 24/a të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se “*Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:*

a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e menjëhershme të masave për nxjerrjen e Udhëzimit në zbatim të Vendimit nr.722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të tyre”, Kreu IV, pika 5.
2. Marrjen e masave për gjetjen e mekanizmave për përfitimin e paketës higjieno-sanitare të personave me aftësi të kufizuar, të cilët janë deklaruar me Vendime të Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar me Nivel “i rëndë”, para nxjerrjes së aktit nënligjor dhe në varësi të diagnozave mjekësore, të përfitojnë këtë të drejtë të mohuar.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e

dërgimit të rekomandimit”, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit midis institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v